

**DEKRET**  
**Nr. 8332, datë 20.9.2013**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE PËR KRYETAR BASHKIE, BASHKIA KORÇË,  
QARKU KORÇË**

Në mbështetje të nenit 92 germa “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 10 paragrafi 3 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar),

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Caktimin e datës 3 nëntor 2013, për zhvillimin e zgjedhjeve për kryetar të bashkisë Korçë, qarku Korçë.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**